



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 12.2, shkronja (c) të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, nenit 34.1, shkronja (c) të Statutit të Komunës së Prishtinës, nenit 40 të Ligjit nr. 2004/18, për tregtinë e brendshme, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-005, për tregtinë e brendshme, dhe të nenin 7 të Rregullores nr. 11/2013, për implementimin e standardeve për klasifikimin e veprimtarive ekonomike në versionin NACE-Rev-2, të dt. 16.04.2013, në mbledhjen e mbajtur më _____, e miratoi këtë

**PROJEKTRREGULLORE
PËR
FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË VEPRIMTARIVE
AFARISTE DHE VEPRIMTARIVE TJERA NË KOMUNËN E PRISHTINËS**

I. DISPOZITAT E PËRGJTHSHME

**Neni 1
Qëllimi**

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për shoqëritë tregtare, afariste dhe veprimtaritë tjera biznesore të cilat veprojnë në territorin e komunës së Prishtinës.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 2004/18, për tregti të brendshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 17, dt. 01.09.2007), Ligjit nr. 04/L-005, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/18, për tregti të brendshme (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 05, dt. 21.07.2011) dhe Klasifikimin e veprimtarive ekonomike NACE Ref. 2, të publikuar më 18.10.2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës të përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

3.1. Orari i punës - periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës.

3.2. Ditë pune - periudha kohore e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte.

3.3. Ditë vikendi - periudha kohore e fundjavës (dita e shtunë dhe e diele).

3.4. Festa zyrtare - ditët të cilat janë të përcaktuara si festa sipas Ligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës.

3.5. Sektor - pjesë ose zonë që është e dallueshme nga një tjetër (p.sh. sektori privat, sektori publik).

3.6. Ndarja - ndarja e sektorëve sipas veprimtarive.

3.7. Nënndarja - ndarje shtesë sipas sektorëve.

3.8. Periudha verore - është periudhë sezonale, që fillon në muajin prill dhe përfundon në muajin shtator.

3.9. Periudha dimërore - është periudhë sezonale, që fillon në muajin tetor dhe përfundon në muajin mars.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

4.1. Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.

4.2. Periudha kohore e fillimit dhe mbarimit të punës caktohet për ditë të rregullta të punës, ditë të punës gjatë vikendeve dhe ditë të punës gjatë festave zyrtare.

4.3. Orari për fillimin dhe mbarimin e punës, i përcaktuar sipas kësaj rregulloreje, duhet të vendoset në hyrje të objektit apo në pjesë të dukshme ku ushtrohet veprimtari afariste, duke e saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, si dhe ditët kur nuk mund të punohet.

Neni 5

5.1. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në interval kohor:

5.1.1. periudha verore fillon më 1 prill dhe mbaron më 30 shtator të vitit kalendarik;

5.1.2. periudha dimërore fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 mars të vitit kalendarik.

Neni 6

- 6.1. Sipas rregullores, orari i punës i shoqërive tregtare klasifikohet sipas veprimtarive ekonomike të radhitura sipas Nomenklaturës NACE Rev. 2.
- 6.2. Klasifikimi i veprimtarive ekonomike të radhitura sipas Nomenklaturës NACE Rev. 2, është sipas sektorëve (ndarjeve, grupeve, nëngrupeve dhe klasave), ku njëherësh ky klasifikim përfshihet edhe në këtë rregullore.
- 6.3. Orari i punës i veprimtarive ekonomike të klasifikuara në Nomenklaturë NACE Rev. 2, e që do të përfshihen në këtë rregullore sipas sektorëve:
- 6.3.1. Sektori (A) Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi;
 - 6.3.2. Sektori (B) Minierat dhe guroret (industria nxjerrëse);
 - 6.3.3. Sektori (C) Industria përpunuese;
 - 6.3.4. Sektori (E) Furnizimi me ujë, kanalizimi, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave;
 - 6.3.5. Sektori (F) Ndërtimtaria;
 - 6.3.6. Sektori (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave;
 - 6.3.7. Sektori (H) Transporti dhe magazinimi;
 - 6.3.8. Sektori (I) Akomodimi dhe shërbimi ushqimor;
 - 6.3.9. Sektori (M) Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike;
 - 6.3.10. Sektori (P) Arsimi;
 - 6.3.11. Sektori (Q) Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale;
 - 6.3.12. Sektori (R) Artet, argëtimi dhe rekreacioni;
 - 6.3.13. Sektori (S) Veprimtaritë e tjera shërbyese.

Neni 7

SEKTORI (A) Bujqësia , pylltaria dhe peshkimi

- 7.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të pylltarisë dhe prerja e drunjve, ndarja 02, grupi 02.1, klasa 02.10 fillon:
- 7.1.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 20:00;
 - 7.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 18:00.
- 7.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në fushën e peshkimit dhe akuakulturës, ndarja 03, grupi 03.1, klasa 03.12 fillon:
- 7.2.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00;
 - 7.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

7.3. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 7, paragrafët 7.1 dhe 7.2, do të punojnë sipas orarit të paraparë për ditët e punës.

Neni 8

S E K T O R I (B) **Minierat dhe guroret (industria nxjerrëse)**

8.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te xeheroret dhe guroret tjera, ndarja 08, grupi 08.1, klasa 08.11, 08.12 fillon:

8.1.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 18:00;

8.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

8.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te minierat dhe guroret (industria nxjerrëse) p.k.t., ndarja 08, grupi 08.9, klasa 08.99 fillon:

8.2.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 18:00;

8.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

8.3. Shoqëritë tregtare sipas nenit 8, paragrafët 8.1 dhe 8.2, të shtunave do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë.

Neni 9

S E K T O R I (C) **Industria përpunuese**

9.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te përpunimi i produkteve ushqimore, ndarja 10, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 10, fillon:

9.1.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 23:00;

9.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.

9.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i pijeve, ndarja 11, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 11, fillon:

9.2.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 23:00;

9.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.

9.3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te prodhimi i tekstilit, veshjeve, prodhimi i lëkurës dhe produkteve të lëkurës, ndarja 13, 14 dhe 15, duke përfshirë të gjitha grupet

dhe klasat e ndarjeve 13, 14 dhe 15, do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00.

9.4. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të prodhimi të drurit dhe të produkteve të drurit, të tapës, përveç mobileve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara, thurëse, prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës dhe shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara, prodhimi i produkteve kimike, prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike, prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës, prodhimi i produkteve minerale jo materiale, prodhimi i metaleve, prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve, prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektrike dhe optike, prodhimi i pajisjeve elektrike, prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t., prodhimi i makinerive motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove, prodhimi i mobileve, prodhimi tjetër p.k.t. dhe riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve ndarja 16, 17,18, 20, 21, 22, 23, 24, 25,26, 27, 28, 29, 32,33 duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjeve 16, 17,18, 20, 21, 22, 23, 24, 25,26, 27, 28, 29, 32,33, do të jetë i njëjtë në dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 23:00.

9.5. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 9, paragrafët 9.1,9.2, 9.3 dhe 9.4, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar gjatë ditëve të punës.

Neni 10

SEKTORI (E)

Furnizimi me ujë, kanalizimi, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave

10.1. Orari i punës të veprimtaritë: furnizim me ujë, kanalizim, veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve, trajtimi i mbeturinave dhe asgjësimi i tyre, ndarja 37, grupin 37.0, klasën 37.00, ndarja 38, grupin 38.1, klasën 38.11 dhe 38.12, ndarja 38, grupin 38.2, klasën 38.21 dhe 38.22, do të jetë i njëjtë në dy sezonet, fillon prej orës 00:00 deri në ora 24:00 (pa ndërprerë).

10.2. Gjatë ditëve të vikendit (të shtunave dhe të dielave) dhe festave zyrtare shoqëritë tregtare, sipas nenit 10, par.10.1, do të punojnë me orar të njëjtë.

Neni 11

SEKTORI (F) Ndërtimtaria

11.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të ndërtimit të objekteve, ndarja 41, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 41, fillon:

11.1.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 20:00 ;

11.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 17:00.

11.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të punimet inxhinierike, ndarja 42, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 42, fillon:

11.2.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 20:00;

11.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

11.3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të veprimtarive të ndërtimit të specializuar, ndarja 43, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 43, fillon:

11.3.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 20:00;

11.3.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

11.4. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 11, paragrafi 11.1, 11.2 dhe 11.3, nuk do të punojnë, përjashtim mund të ketë vetëm kur iu lejohej me pëlqimin e organit kompetent të Komunës.

Neni 12

SEKTORI (G) Tregtia me shumicë, pakicë dhe riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave

12.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të tregtisë me shumicë dhe pakicë, si dhe riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, ndarja 45 dhe 46, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 45 dhe 46, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 20:00;

12.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës të tregtisë me pakicë, ndarja 47, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e ndarjes 47, fillon:

12.2.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 23:00:

12.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.

12.3. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 12, paragrafi 12.1, do të punojnë me orar të njëjtë si gjatë ditëve të punës.

12.4. Përrjashtim nga neni 12, paragrafi 12.2, shitja e derivateve të naftës me pakicë, duhet të punojë nga ora 00:00 deri në orën 24:00 (pa ndërprerë për çdo ditët të javës).

Neni 13

SEKTORI (H) Transporti dhe magazinimi

13.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te magazinimi dhe veprimtaritë mbështetëse për transport, ndarja 52, grupi 52.1, 52.2, klasa 52.10, 52.21, 52.29, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 20:00;

13.2. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 13 paragrafi 13.1, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë.

Neni 14

SEKTORI (I) Akomodimi dhe shërbimi ushqimor

14.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te hotelet dhe akomodimi i ngjashëm, ndarja 55, grupin 55.1, 55.2 dhe 55.9 me të gjitha klasat e grupeve 55.1, 55.2 dhe 55.9, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, 24 orë në ditë;

14.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë shërbyese të ushqimit dhe pijeve, restorantet dhe veprimtaritë shërbyese lëvizëse të ushqimit, ndarja 56, grupin 56.1, dhe 56.2 me klasë e këtyre grupeve, fillon:

14.2.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 24:00;

14.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.

14.3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë shërbyese të pijeve, bareve, diskotekave etj., ndarja 56, grupin 56.3 dhe 56.2, klasa 56.30, fillon:

14.3.1. periudha verore, prej orës 20:00 deri në orën 24:00;

14.3.2. periudha dimërore, prej orës 20:00 deri në orën 23:00.

14.4. Gjatë ditëve të vikendit dhe festave zyrtare shoqëritë tregtare, sipas nenit 14 paragrafi 14.1, 14.2 dhe 14.3, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës.

Neni 15

SEKTORI (M)

Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike

15.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e arkitekturës dhe inxhinierisë; analizat dhe testimet teknike, ndarja 71, grupi 71.1 klasa 71.11 dhe 71.12, fillon në orën 08:00 dhe mbaron në orën 20:00 në të dy sezonet.

15.2. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 15, paragrafët 15.1 dhe 12.2 nuk do të punojnë.

Neni 16

SEKTORI (P)

Arsimi

16.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në fushën e arsimit, ndarja 85, grupi 85.1 , 85.2, 85.3, 85.4 me nënklasat fillon:

16.1.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00 ;

16.1.2. periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00 .

16.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës në fushën e arsimit, ndarja 85, grupi 85.5 me nënklasat e grupit fillon:

16.2.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 21:00;

16.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 21:00.

16.3. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 16, paragrafët 16.1 dhe 16.2 do të punojnë me orar të shkurtër nga ora 08:00 deri në ora 12:00.

Neni 17

SEKTORI (Q) Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale

17.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e shëndetit të njeriut, veprimtaritë e spitaleve, ndarja 86, grupi 86.1, klasa 86.10, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, 24 orë në ditë;

17.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e shëndetit të njeriut, ndarja 86, grupi 86.2 dhe me të gjitha nënklasat e këtyre grupeve, fillon:

17.2.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00;

17.2.2. periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00.

17.3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi, ndarja 87, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e grupit 87, do të jetë i njëjtë në të dy sezonet, 24 orë në ditë.

17.4. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e përkujdesjes në shtëpi, ndarja 88, duke përfshirë të gjitha grupet dhe klasat e grupit 88, fillon:

17.4.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00;

17.4.2. periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 20:00.

17.5. Shoqëritë tregtare sipas nenit 17, paragrafi 17.2, 17.3 dhe 17.4, të shtunave do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës, ndërsa të dielave nuk do të punojnë. Përjashtim mund të ketë në rastet kur pajiset me pëlqim nga organi kompetent i Komunës.

Neni 18

SEKTORI (R) Artet, argëtimi dhe rekreacioni

18.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë krijuese, artistike dhe argëtuese, ndarja 90, grupi 90.0, klasa 90.01 dhe 90.02, fillon:

- 18.1.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 24:00;
- 18.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.

18.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e lojërave të fatit dhe basteve, ndarja 92, grupi 92.0, klasa 92.00, fillon:

- 18.2.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 24:00 ;
- 18.2.1. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00.

18.3. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë sportive, argëtuese dhe veprimtaritë e rekreacionit, ndarja 93, grupi 93.1 dhe 93.2, fillon:

- 18.3.1. periudha verore, prej orës 07:00 deri në orën 24:00 ;
- 18.3.2. periudha dimërore, prej orës 07:00 deri në orën 24:00.

18.4. Gjatë ditëve të vikendit (të shtunave dhe të dielave) shoqëritë tregtare, sipas nenit 18, paragrafi 18.1, 18.2 dhe 18.3, do të punojnë sipas orarit të përcaktuar të ditëve të punës.

Neni 19

SEKTORI (S) Veprimtaritë e tjera shërbyese

19.1. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te riparimi i kompjuterëve, këpucëve, orëve të dorës dhe artikujve të tjerë personalë dhe shtëpiakë etj., ndarja 95, me grupe dhe klasa, të ndarjes 95, fillon:

- 19.1.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00;
- 19.1.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.

19.2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës te veprimtaritë e tjera shërbyese, ndarja 96, grupi 96.0, klasa 92.01, 96.02, 96.03, 96.04 dhe 92.09, fillon:

- 19.2.1. periudha verore, prej orës 08:00 deri në orën 23:00;
- 19.2.2. periudha dimërore, prej orës 08:00 deri në orën 22:00.

19.3. Gjatë ditëve të vikendit shoqëritë tregtare, sipas nenit 19, paragrafët 19.1 dhe 19 b.2, nuk do të punojnë, përveç në rast se jepet pëlqim nga organi kompetent i Komunës.

19.4. Përjashtim nga neni 19, paragrafi 19.2 dhe 19.3, ndarja 96, grupi 96.0, klasa 96.03, shoqëritë tregtare për kryerjen e shërbimeve të funeraleve dhe veprimeve të lidhura me të, mund të punojnë 24 orë në ditë gjatë tërë javës.

III. Zgjatja dhe shkurtimi i orarit të punës

Neni 20

20.1 Shoqëritë tregtare mund të punojnë më gjatë se orari i punës i paraparë me këtë rregullore, por jo më gjatë se deri në orën 02.00. Për punë më të gjatë se orari i paraparë, duhet marrë pëlqimin nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Kërkesa për zgjatje të orarit të punës duhet t'i parashtrohet Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, së paku 48 orë më parë dhe duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:

- 20.1.1. Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- 20.1.2. Certifikata e numrit fiskal të biznesit;
- 20.1.3. Letërnjoftimi i pronarit;
- 20.1.4. Certifikata e lëshuar nga organi kompetent për emetimin e zhurmës;
- 20.1.5. Certifikata e lëshuar nga organi kompetent për emetimin e ndotjes;
- 20.1.6. Vendimi nga Bashkësia lokale, se zgjatja e orarit të punës nuk është pengesë për komunitetin;
- 20.1.7. Për rastet e ndërtimit të ultë dhe të lartë, sipas lejes (pëlqimi nga Drejtoria e Urbanizmit).

20.2. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm që e miraton apo e refuzon kërkesën për zgjatjen e orarit të punës, nxjerr aktvendim dhe e njofton palën dhe organet kompetente 24 orë më parë.

20.3. Për çdo orë të zgjatur të orarit të punës së paraparë me këtë rregullore, shoqëritë tregtare, sipas sektorëve, duhet të paguajnë:

- 20.3.1. Sektori (A) Bujqësi, pylltari dhe peshkim, **0.00 Euro**;
- 20.3.2. Sektori (B) Minierat dhe guroret (industrial nxjerrëse) **20.00 Euro**;
- 20.3.3. Sektori (C) Industria përpunuese, **20.00 Euro**;
- 20.3.4. Sektori (E) Furnizimi me ujë, kanalizimi, veprimtaritë e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave, **0.00 Euro**;
- 20.3.5. Sektori (F) Ndërtimtaria, **20.00 Euro**;
- 20.3.6. Sektori (G) Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, **10.00 Euro**;
- 20.3.7. Sektori (H) Transporti dhe magazinimi, **20.00 Euro**;
- 20.3.8. Sektori (I) Akomodimi dhe shërbimi ushqimor, **10.00 Euro**;

- 20.3.9. Sektori (M) Veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike, **10.00 Euro**;
- 20.3.10. Sektori (P) Arsimi, **0.00 Euro**;
- 20.3.11. Sektori (Q) Veprimtaritë e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale, **0.00 Euro**;
- 20.3.12. Sektori (R) Artet, argëtimi dhe rekreacioni, **20.00 Euro**;
- 20.3.13. Sektori (S) veprimtaritë e tjera shërbyese, **10.00 Euro**.
- 20.4. Përfshirje nga neni 20, paragrafi 20.3, bëjnë shoqëritë tregtare të cilat realizojnë projekte me donacione me interes publik, d.m.th. lirohen nga pagesa.

Neni 21

- 21.1. Shoqëritë tregtare mund të punojnë me orar më të shkurtë se orari i punës që është paraparë me këtë rregullore.
- 21.2. Për shkurtimin e orarit të punës më shkurt se orari i paraparë në këtë rregullore, shoqëritë tregtare afariste duhet të vendosin njoftimin me shkrim në hyrje të objektit në të cilin ushtrojnë veprimtarinë afariste, duke e saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës dhe ditët kur nuk punohet.
- 21.3. Me rastin e inspektimit nga inspektori për respektimin e orarit të punës, për shkurtimin e orarit të punës, shoqëritë tregtare duhet ta njoftojnë inspektorin për shkurtimin e orarit të punës dhe i njëjti duhet ta evidentojë në procesverbal.
- 21.4. Përfshirje bëjnë shoqëria tregtare që vepron sipas nenit 21.2 të kësaj rregulloreje, për shkurtimin e orarit të punës më shkurt se orari i paraparë, nuk mund të sanksionohet sipas dispozitave ndëshkuese të kësaj rregulloreje.

Neni 22

- 22.1. Sipas Ligjit për festa zyrtare të Republikës së Kosovës dhe kësaj rregulloreje, shoqëritë tregtare nuk mund të punojnë gjatë festave zyrtare.
- 22.2. Përfshirje nga paragrafi 22.1 i kësaj rregulloreje, shoqëritë tregtare të sektorit të hotelierisë dhe sektorit që punojnë 24 orë në ditë (ditë pune dhe vikendeve) mund të punojnë edhe ditëve të festave zyrtare sipas orarit të ditëve të punës.
- 22.3. Shoqëritë tregtare të cilat e kanë të lejuar të punojnë sipas nenit 22, paragrafi 22.2, mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 01:00 (të mëngjesit) dhe të njëjtit nuk paguajnë taksa shtesë.

Neni 23

23.1. Shoqëritë tregtare të cilat marrin pëlqim për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve, pas konstatimit nga Drejtoria e Inspeksionit, do t'i revokohet pëlqimi për zgjatje të orarit të punës nga

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe do të gjobitet për kundërvajtje nga Drejtoria e Inspeksionit, sipas nenit 25 të kësaj rregulloreje.

23.2. Drejtoria e Planifikimit Strategjikë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm rezervon të drejtën për revokimin e aktvendimit për zgjatjen e orarit të punës, atëherë kur konsideron që ka devijuar nga kërkesa e parashtruar për zgjatje apo shkurtim të orarit të punës, me theks të veçantë kur konstatohet që vazhdimi i mëtutjeshëm i zgjatjes së orarit të punës shkakton pengesa për komunitetin dhe është në kundërshtim me ligjet në fuqi.

IV. INSPEKTIMI

Neni 24

24.1. Inspektori në bazë të kërkesës së qytetarëve dhe detyrës zyrtare, mund të inspektojë shoqëritë tregtare lidhur me respektimin e orarit të punës sipas kësaj rregulloreje.

24.2. Gjatë inspektimit të shoqërive tregtare, inspektori duhet të inspektojë se a është vendosur njoftimi – publikimi i orarit të punës dhe ditëve kur nuk punohet, në vendin e dukshëm në hyrje të objektit afarist ku shihet dhe se a është zgjatur apo shkurtuar orari i punës sipas kësaj rregulloreje.

24.3. Nëse shoqëritë tregtare që nuk u përmbahen dispozitave të nenit 23, paragrafi 23.2 të kësaj rregulloreje, inspektori gjatë inspektimit për herë të parë, e njofton shoqërinë tregtare me shkrim përmes procesverbalit, në të kundërtën, nëse veprohet edhe herën tjetër njësoj, atëherë do të shqiptohen masa ndëshkuese.

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 25

25.1. Të gjitha organizatat e biznesit do të gjobiten për kundërvajtje, në qoftë se veprojnë në kundërshtim me nenet 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të kësaj Rregulloreje, si më poshtë:

25.1.1.	persona juridikë.....	1000.00 – 3000.00
	€;	
25.1.2.	persona fizikë.....	300.00 – 1000.00
	€.	

VI. DISPOZITAT SHFUQIZUESE

Neni 26

Me hyrjen e në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr. 110-1203, dt.16.06.2010, dhe Vendimi, 01. nr.031-2972, dt.15.12.2010 për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, 01. nr.110-1203, dt.16.06.2010.

VII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 27

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset Drejtoria e Inspeksionit, në bashkëpunim me zyrtarët e Policisë së Kosovës dhe Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Neni 28

Të gjitha shoqëritë e biznesit janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 29

Klasifikimi i veprimtarive ekonomike NACE Ref. 2, të publikuar më 18.10.2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, konsiderohet pjesë e kësaj rregulloreje dhe i bashkëngjitet si shtojcë.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 nr. , dt.

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta